REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 korrik 2025
Nr. Ref.:AGJ 2746/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI221/23

Parashtrues

Rexhep Gaxherri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën civile C.nr.18/03, respektivisht C.nr.158/12 nga Gjykata Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rexhep Gaxherri, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Korab Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), përkitazi me lëndën civile C. nr. 18/03, respektivisht C. nr.158/12.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore, me pretendimin se mosvendosja për lëndën civile [C. nr. 158/12] nga Gjykata Themelore, cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara përmes paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës elektronike në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 tetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

7. Më 20 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [GJR.KI221/23] e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin [KSH.KI221/23] i caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).

8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi e dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

9. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullin 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe vendimin e lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24], gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimin e lartcekur të Gjykatës u

përcaktua që Gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.

10. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimin [KK-SP 812-1/24] e 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi e mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani e përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi e përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 4 mars 2025, Gjykata përmes shkresës [Nr. ref.: 218/25/drlsa] i kërkoi Gjykatës Themelore informata rreth fazës procedurale në të cilën gjendet shqyrtimi i kërkesëpadisë, përkitazi me lëndën civile C. nr. 18/03, respektivisht C. nr.158/12.

12. Më 12 mars 2025, Gjykata Themelore përmes shkresës [AGJ. nr. 61/25] e njoftoi Gjykatën për statusin e lëndës civile C. nr. 18/03, respektivisht C. nr.158/12, dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga e njëjta.

13. Më 25 mars 2025, Gjykata ia kërkoi Gjykatës Themelore dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 3 prill 2025, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen e plotë të lëndës në sekretariatin e Gjykatës.

15. Më XX prill 2025, Gjykata e ktheu dosjen përkatëse të lëndës në Gjykatën Themelore.

16. Më 3 korrik 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Faktet në lidhje me parashtrimin e padisë (1989-1998)

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 19 korrik 1991, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), për kompensimin e kundërvlerës së paluajtshmërisë në sipërfaqen prej 0.41,30 hektarësh, e cila ka qenë objekt i shpronësimit në pranverën e vitit 1989, për qëllime të ndërtimit të rrugës Gjakovë-Ponoshec. Me pretendimin për moskompensim të paluajtshmërisë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar që t'i kompensohej shuma prej tetëmijë e njëqind (8.100,00) dinarë jugosllavë, si vlerë fillestare, e cila do precizohej më pas nga një ekspert përkatës. Më 18 shkurt 1992, Gjykata Komunale nëpërmjet Aktgjykimit [Civ.nr.597/91], e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se të njëjtit i mungon legjitimiteti i plotë aktiv për të qenë palë në procedurë, meqenëse paluajtshmëria *"[...] në avio inqizimin e fundit i cili është aplikuar nga muaji maj i vitit 1988 nuk është evidentuar në emër të paditësit* (parashtruesit të kërkesës), *nga e cila rrjedh se paditësi me avio inqizim nuk e fiton të drejtën e pronësisë në patundshmërinë lëndore"*. Rrjedhimisht, Gjykata Komunale kishte theksuar se krahas parashtruesit të kërkesës (paditësit), edhe të paditurve u mungonte legjitimiteti i plotë pasiv. Më 9 qershor 1995, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit [Civ. nr. 597/91] të 18 shkurtit 1992 të Gjykatës Komunale, për shkak të (i)

shkeljes së dispozitave procedurale, (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Qarkut të aprovojë ankesën, rrjedhimisht kërkesëpadinë, ose çështjen ta kthejë në rivendosje në shkallën e parë. Më 27 shtator 1995, Gjykata e Qarkut nëpërmjet Aktvendimit [Gzh. nr. 287/95] e kishte prishur Aktgjykimin [Civ. nr. 597/91] e Gjykatës Komunale, të 18 shkurtit 1992, si pasojë e (i) konstatimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) arsyetimit të paqartë dhe kontradiktor, i cili nuk përputhej me provat e administruara. Si rezultat, Gjykata e Qarkut, Aktgjykimin [Civ. nr. 597/91] e kishte kthyer në rigjykim, me qëllim të konstatimit të pronësisë përkitazi me paluajtshmërinë kontestuese. Më 22 prill 1996, Gjykata Komunale e kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës që të precizonte padinë, në kuptimin subjektiv, respektivisht të qartësimit të palës së paditur. Më 20 maj 1996, parashtruesi i kërkesës e kishte precizuar kërkesëpadinë. Më 19 qershor 1997, Gjykata Komunale nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 369/95] e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se palëve të paditura u mungonte legjitimiteti pasiv procedural, duke qenë se Drejtoria për Rrugë nuk mund të konsiderohej si suksesore juridike e Bashkësisë Vetëqeverise. Më 25 maj 1998, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit [C. nr. 369/95] të 19 qershorit 1997, e cila nëpërmjet Aktvendimit [Gzh. nr. 575/98] të 8 tetorit 1998 e kishte prishur Aktgjykimin [C. nr. 369/95] e Gjykatës Komunale të 19 qershorit 1997, dhe e kishte kthyer çështjen në rivendosje. Gjykata e Qarkut në arsyetimin e vendimit kishte theksuar se në aktgjykimin e goditur *"[...] faktet vendimtare ishin të paqarta dhe kundërthënëse [...]"*, si dhe i njëjti *"[...] përmban shkelje të theksuara të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore të përcaktuara në nenin 354, par. 2, pika 7 [...]"*.

Faktet në lidhje me vazhdimin e procedurës (2003-2025)

18. Më 20 janar 2003, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për vazhdimin e procedurës gjyqësore për lëndën civile [C. nr. 612/98] pranë Gjykatës Komunale, e cila më pas kishte marrë numër të ri [C. nr. 18/03].

19. Më 8 janar 2007, parashtruesi i kërkesës e kishte precizuar padinë në kuptim subjektiv, duke e paditur (i) Ministrinë e Komunikacionit dhe Telekomunikacionit të Kosovës, dhe (ii) Komunën e Gjakovës, me kërkesën që të paditurat të detyrohen që t'i paguajnë atij shumën prej njëqind mijë (100.000) Euro, duke përfshirë kamatën ligjore nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, si shpërblim në emër të privimit të pabazë nga paluajtshmëria e tij.

20. Më 23 prill 2007, Gjykata Komunale mbajti seancën e shqyrtimit kryesor, pas vazhdimit të procedurës sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës u vendos dalja në vendngjarje më 8 qershor 2007.

21. Nga viti 2003 deri në vitin 2011, përkitazi me çështjen civile në fjalë janë mbajtur në tërësi katërmbëdhjetë (14) seanca gjyqësore.

22. Më 18 korrik 2008, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozimin për pezullimin e procedurës, duke iu referuar nenit 68 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili përcaktonte se me hyrjen në fuqi të tij, procedurat gjyqësore të cilat ishin duke u zhvilluar dhe rrjedhimisht kishin si palë organin publik që nuk ishte Ministria e Drejtësisë, pezulloheshin brenda një afati prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh.

23. Më 4 shtator 2008, Gjykata Komunale, me aktvendim vendosi për pezullimin e procedurës.

24. Më 27 janar 2010, Gjykata Komunale mbajti seancë për vazhdimin e shqyrtimit të lëndës civile. Pezullimi i procedurës zgjati një vit (1) e pesë (5) muaj.

25. Më 2 dhjetor 2011, Gjykata Komunale nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr.18/03] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke kontestuar të drejtën e pronësisë së tij në paluajtshmërinë kontestuese. Gjykata Komunale në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka sqaruar se *"[...] në asnjë fazë të procedurës përpos evidentimit formal në Drejtorinë për kadastër, gjeodezi dhe pronë në Gjakovë, nuk është vërtetuar baza e fitimit të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese nëpër të cilën kalon traseja e rrugës Gjakovë-Ponoshec [...]"*. Po ashtu, kjo gjykatë ka theksuar mosekzistimin e kontinuitetit juridik në mes të institucioneve paraprake dhe atyre aktuale në cilësinë e palëve të paditura, respektivisht *"[...] e paditura e parë Qeveria e Kosovës–Ministria e Komunikacionit dhe Telekomunikacionit në Prishtinë, [...] nuk është trashëgimtare e BVI-së për rrugë magjistrale dhe rajone e KSA të Kosovës, por entitet i ri i themeluar pas luftës në Kosovë [...]"*, ndërkaq në raport me të paditurën e dytë, Komunën e Gjakovës, është theksuar se të njëjtës i mungon autoriteti për menaxhimin e rrugëve publike, magjistrale e regjionale, meqenëse të njëjtin autoritet e ushtron Ministria përkatëse.

26. Më 30 janar 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit [C. nr. 18/03] të 2 dhjetorit 2011, për shkak të: (i) cenimeve të rënda të dispozitave të procedurës civile, (ii) vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike, (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe (iv) vendimit për shpenzimet materiale; duke i propozuar Gjykatës së Qarkut që aktgjykimin e goditur ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

27. Më 23 prill 2012, Gjykata e Qarkut nëpërmjet Aktvendimit [Ac. nr. 159/12] vendosi ta prishë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C. nr. 18/03] të 2 dhjetorit 2011 dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim. Në arsyetim të aktvendimit, Gjykata e Qarkut theksoi se *"[...] aktgjykimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore [...]"*, posaçërisht në kontekst të vërtetimit të fakteve dhe administrimit të provave. Gjykata e Qarkut ndër të tjera ka theksuar se lënda është kthyer në riprocedurë, ashtu që *"[...] në mënyrë të përshtatshme nëpërmes fakteve jokontestuese, të vërtetohen në bazë të ekspertit gjeodet faktet dhe rrethanat e cituara më lartë, dëgjimin e dëshmitarëve të cilit kishin me vërtetur faktet, kohën kur është dhënë pëlqimi për ndërtimin e rrugës, kohën kur është shitur paluajtshmëria nga ana e ish pronarit – paditësit, dhe mënyrën e shitjes , gjithashtu të vërtetohet ndonjë ndryshim apo ndërrim i ngastrave nëpër të cilat ka kaluar rruga dhe qe tani eventualisht mund të jetë pjesë e këtij kontesti."*.

28. Më 16 mars 2016, Gjykata Themelore zhvilloi takimin me palët ndërgjyqëse përkitazi me lëndën, pas rekomandimeve të dala nga Strategjia shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra.

29. Më 23 mars 2017, Gjykata Themelore mbajti seancën e shqyrtimit përgatitor, e cila për shkaqe teknike që lidheshin me shkresat e lëndës është shtyrë dhe caktuar për datën 24 maj 2017.

30. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që pas vitit 2011, e deri më 9 nëntor 2023 janë mbajtur në tërësi gjashtëmbëdhjetë (16) seanca gjyqësore.

31. Më 4 mars 2024, me qëllim të qartësimit të procedurave në lidhje me lëndën civile [C. nr. 18/03], respektivisht [C.nr.158/12], Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore informata shtesë për lëndën. Më 12 mars 2024, kjo e fundit dorëzoi në Sekretariatin e Gjykatës informata në lidhje me statusin e lëndës, duke e njoftuar Gjykatën për çështjen civile në fjalë, se më 9 nëntor 2023 është mbajtur seancë në të cilën janë aprovuar propozimet për nxjerrjen e provës me plotësim të ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë, si dhe është kërkuar sigurimi i historiatit nga Arkivi i Komunës së Gjakovës. Ashtu që, sipas gjyqtares së çështjes, këto kërkesa janë dërguar në fillim të vitit 2024 dhe ridërguar sërish, por që Gjykata Themelore nuk ka marrë ende përgjigje nga organi kompetent. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën që në momentin e pranimit të shkresave të kërkuara nga ekspertët dhe organet publike do të vazhdohet me procedim të mëtutjeshëm të lëndës.

32. Më 25 mars 2025, me qëllim të qartësimit të mëtutjeshëm të procedurave në lidhje me lëndën civile [C. nr. 18/03], respektivisht [C.nr.158/12], Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore dosjen e plotë, të cilën kjo e fundit e dorëzoi në Sekretariatin e Gjykatës më 3 prill 2025. Gjykata Themelore nëpërmjet shkresës [AGJ. nr. 61/25] të 12 marsit 2025, e informoi Gjykatën për statusin aktual të lëndës dhe për veprimet procedurale të ndërmarra nga e njëjta. Kjo gjykatë thekson se në seancën e 9 nëntorit 2023 (seanca e fundit e mbajtur në GjThGj) janë aprovuar propozimet për nxjerrjen e provave dhe plotësimin e ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë, si dhe propozimi për sigurimin e historiatit nga Arkivi i Komunës së Gjakovës. Në këtë drejtim, shkresa e lartpërmendur thekson se më 21 qershor 2021, gjyqtarja e ngarkuar me lëndën ka proceduar me dërgimin dhe ridërgimin e kërkesave në institucionet respektive, por që akoma nuk është siguruar përgjigjja nga këto organe kompetente. Gjithashtu, është cekur se në momentin e pranimit të shkresave të nevojshme, rrjedhimisht të kërkuara, do të vazhdohet me procedimin e mëtutjeshëm të çështjes.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës së rastit e cila është në shqyrtim para Gjykatës Themelore. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me pretendimin e tij për mosveprim të Gjykatës Themelore për zgjidhje të çështjes që ndërlidhet me shpronësimin e paluajtshmërisë së tij.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij janë të aplikuara parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GjEDNj dhe praktika gjyqësore e Gjykatës, përkitazi me tejzgjatjen e procedurave. Parashtruesi i kërkesës thekson se kjo çështje daton herët, për të cilën janë caktuar gjykime në datat: 18 shkurt 1992; 9 qershor 1995; 27 shtator 1995; 20 maj 1996; 19 qershor 1997; 8 tetor 1998.

35. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se janë shkelur edhe të drejtat e tij pronësore, pasi që nuk është kompensuar dhe se ai *"[...] nuk është fajtor se Republika e Kosovës nuk ka nxjerrë Ligjin për procedurat e kompensimit të dëmit për shkak të shkeljes... së të drejtave fundamentale."*.

36. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së që i referohet të drejtës në gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor; (iii) të detyrohet Republika e Kosovës që t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të *"dhimbjeve shpirtërore"* si pasojë e shkeljeve të drejtave elementare njerëzore, shumën prej 10.000,00 euro.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]".

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
> *[...]*

39. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

40. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 158/12].

41. Për më tepër, Gjykata duhet të vlerësojë gjithashtu nëse kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, që përcakton:

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

42. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore, për mosvendosje në kohë të lëndës civile [C. nr. 18/03] respektivisht [C.nr.158/12], e cila ende nuk ka përfunduar pranë kësaj të fundit. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajsh.

43. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës specifikon se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjegjësisht, *"gjykimi në afat të arsyeshëm kohor"* e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KENDJ-së.

44. Përveç kritereve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

[...]

45. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

46. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

47. Gjykata fillimisht rikujton se kontesti juridik-civil është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës nëpërmjet padisë së 19 korrikut 1991, ku sipas shkresave të lëndës rezulton se paluajtshmëria kontestuese është shpronësuar me qëllim të ndërtimit të rrugës Gjakovë-Ponoshec - Qafë Morinë. Procedura në vijim ka për bazë kërkesën për kompensim të paluajtshmërisë së shpronësuar, e që më 18 shkurt 1992 Gjykata Komunale me Aktgjykimin [Civ. nr. 597/91] e kishe refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për mungesë të legjitimitetit të plotë aktiv të parashtruesit të kërkesës dhe mungesë të legjitimitetit të plotë pasiv të palëve të paditura. Parashtruesi i kërkesës, më 9 qershor 1995 kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut ndaj Aktgjykimit të lartcekur, e cila më 27 shtator 1995 nëpërmjet Aktvendimit [Gzh. nr. 287/95] e prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe lëndën e ktheu në rigjykim. Në procedurën e rigjykimit, më 19 qershor 1997, Gjykata Komunale nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 369/95] e refuzoi sërish kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, për mungesë të legjitimitetit të plotë pasiv të të paditurave. Më 25 maj 1998, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut dhe kjo e fundit më 8 tetor 1998 e prishi Aktgjykimin e lartcekur, duke e kthyer serish çështjen në rigjykim, me arsyetimin se faktet vendimtare ishin kundërthënëse dhe të paqarta.

48. Si pasojë e rrethanave objektive në periudhën pasuese, kjo lëndë nuk ishte proceduar më tutje nga Gjykata Komunale. Rrjedhimisht, më 20 janar 2003, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për vazhdimin e procedurës, sipas lëndës [C. nr. 612/98], duke e precizuar padinë në aspektin subjektiv. Gjykata Komunale, më 2 dhjetor 2011, nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 18/03], kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke e kontestuar të drejtën e tij mbi pronësinë kontestuese, si dhe legjitimitetin pasiv të palëve të paditura. Më 27 janar 2012, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut, ndaj Aktgjykimit të lartcekur, e cila nëpërmjet Aktvendimit [Ac. nr. 159/12] të 23 prillit 2012, e kishte prishur aktgjykimin e kontestuar, duke e kthyer lëndën në rivendosje pranë shkallës së parë. Kjo e fundit, më 16 mars 2016, kishte mbajtur një takim me palët ndërgjyqëse si pjesë e strategjisë shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetruara. Ndërkaq, seanca e parë e shqyrtimit përgatitor për çështjen u mbajt më 23 mars 2017, duke vazhduar më pas me gjashtëmbëdhjetë (16) seanca të tjera. Parashtruesi i kërkesës në këtë periudhë kohore pranë Gjykatës Komunale, respektivisht Themelore kishte parashtruar nëntë (9) urgjenca, fillimisht më 18 prill 2013; 7 tetor 2013; 13 janar

2014; 8 shtator 2014; 9 korrik 2015; 9 shkurt 2018; 8 tetor 2018; 22 tetor 2018; 24 shkurt 2023, me qëllim të caktimit të seancës kryesore.

49. Në vijim, Gjykata rikujton esencën që ngërthen kërkesa e parashtruesit të kërkesës, e cila ndërlidhet me pretendimin për tejzgjatjen e procedurave përkitazi me lëndën civile C. nr. 18/03, respektivisht C. nr.158/12, e cila sipas parashtruesit të kërkesës shkel të drejtën e tij për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

50. Andaj, pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, në vazhdim Gjykata do t'i trajtojë duke marrë për bazë parimet e përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata dhe jo vetem është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së

53. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore është vonuar pa arsye në trajtimin e kërkespadisë së tij brenda një afati të arsyeshëm kohor, duke iu referuar parimeve të përgjithshme në lidhje me këte çështje dhe duke kërkuar zbatimin e tyre në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

53. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]"*. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së përcakton se "*Çdo person ka të drejtë që … të dëgjohet … brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë …, e cila do të vendosë … në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij … civile […]"*.

54. Gjykata përkitazi me vendosjen e rasteve në kohë të arsyeshme, tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore që përfshin, por nuk kufizohet në rastet: (i) *KI64/23*, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) *KI106/21*, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) *KI19/21*, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) *KI177/19*, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) *KI19/17*, parashtrues *Fatos Dervishaj,* Aktvendim për papranueshmëri i 20 shkurtit 2018. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GjEDNj, përfshirë rastet: (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 4 shtatorit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë (nr. 1)*, [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016;

(x) *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18281/05, Aktgjykim i 7 marsit 2011; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

(a) Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurës

56. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, Gjykata rikujton se (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë,* cituar më lart, paragrafi 74; *Comingersoll kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë,* cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës: KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82, dhe së fundmi rastin KI142/24 parashtrues: *Fadil Berisha,* Aktgjykimi i 12 shkurtit 2025, paragrafi 47).

57. Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës merret për bazë e gjithë procedura në tërësi, duke përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit (shih rastin e GJEDNJ-së, *König kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, par. 98). Procesi gjyqësor konsiderohet i përfunduar në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga instanca e fundit gjyqësore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, par. 74; *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, par. 50; si dhe rastin e Gjykatës: *KI177/19*, cituar më lart). Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor konsiderohet pjesë integrale e gjithë proceudrës dhe përfshihet në përllogaritjen e kohëzgjatjes së asaj procedure (shih rastin e GJEDNJ-së, *Martins Moreira kundër Portugalisë*, nr. 11371/85, Aktgjykim i 25 tetori 1988, par. 44). Përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurës nuk ndërpritet deri në momentin kur e drejta e fituar bëhet efektive (shih rastin e GJEDNJ-së, *Estima Jorge kundër Portugalisë*, nr. 24550/94, Aktgjykim i 21 prillit 1998, par. 36-38).

59. Gjykata rikujton se është detyrim i shtetit që ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të atillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, cituar më lart, par. 24; dhe *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 142). Administrimi i drejtësisë pa vonesa është shumë i rëndësishëm për të mos rrezikuar efikasitetin dhe kredibilitetin e sistemit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Scordino kundër Italisë* (nr. 1), cituar më lart, par. 224-225). Zgjatja e tepruar e administrimit të drejtësisë, përbën një nga rreziqet kryesore kundër sundimit të ligjit. Kur shkeljet në lidhje me zgjatjen e procedurave gjyqësore bëhen të shpeshta dhe nuk janë raste të izoluara, atëherë akumulimi i këtyre shkeljeve përbën një praktikë e cila është në mospërputhje me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Botazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, par. 22).

60. Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih rastin e GJEDNJ-së, *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, par. 43). Vlerësimi për arsyeshmërinë e zgjatjes së procedurave gjyqësore duhet të bëhet mbi bazën e karakteristikave të një rasti, për shembull në çështjen e ndarjes së trashëgimisë ndërmjet pasardhësve të një personi të vdekur, që zgjati më shumë se 22 vjet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Omdahl kundër Norvegjisë*, cituar më lart, par. 54-55, 471). Kjo arsyeshmëri e zgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (a) kompleksiteti i rastit, (b) sjellja e palës, (c) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (d) rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Sürmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, par. 128; dhe *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 209).

61. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; dhe rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65), të cilat në mënyrë të përmbledhur do të elaborohen në vijim.

(b) Kompleksiteti (ndërlikueshmëria) i rastit

63. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i rastit mund të ndërlidhet me çështjen faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të eksperteve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës, *KI64/23*, cituar më lart, par. 66-67; dhe rastet e GJEDNJ-së, *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 27 tetorit 1994, par. 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9580/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1987, par. 72; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, par. 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 210).

64. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin nacional (vendor), mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 150).

(c) Sjellja e palës

65. Sipas GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, par. 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, cituar më lart , par. 211).

66. Nga pala kërkohet që vetë të jetë i vëmendshëm në ndërmarrjen e hapave dhe veprimeve procedurale, ashtu që të mos përodorë taktika për të shtyrë në favor të tij procedurën (shih

rastin e GJEDNJ-së, *Unión Alimentaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykimi i 7 korrikut 1989, par. 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u mvishet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte zhvilluar brenda një periudhe të aryeshme kohore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Wiesinger kundër Austrisë*, nr. 11796/85, Aktgjykimi i 30 tetorit 1991, par. 57). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e GJEDNJ-së, *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, par. 66).

67. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: mungesën e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat, mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka jurisdiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Vernillo kundër Francës*, cituar më lart, par. 34; *König kundër Gjermanisë*, cituar më lart, par. 103; *Pizzetti kundër Italisë*, nr. 12444/86, Aktgjykim i 26 shkurtit 1992, par. 18; *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, par. 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 7260/17, Aktgjykim i 30 korrikut 2020, par. 95).

(d) Sjellja e autoriteteve kompetente

68. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet, jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për të gjitha institucionet publike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, par. 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm kohor, duhet të vlerësojë nëse procedura në tërësi, përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë më të shpejtë dhe efikase (shih rastin e GJEDNJ-së, *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 211).

69. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih rastin e GJEDNJ-së, *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, par. 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave (shih rastin e GJEDNJ-së, *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, par. 64). Vonesa e shkaktuar nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve, po ashtu nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmang tejzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih rastin e GJEDNJ-së, *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, par. 22).

70. Gjykata në praktikën e vet ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat dhe rrjedhimisht tejzgjatja e procedurës si tërësi të mos shkaktojë pasiguri te palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i qytetarëve ndaj rendit juridik do të rrezikohet (shih rastet e Gjykatës, *KI64/23*, cituar më lart, par. 71-73; dhe *KI06/21*, cituar më lart, par. 67).

(e) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për palën në kontest

71. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë a të shtuar dhe rrjedhimisht për të njëjtat të vendoset me shpejtësi e prioritet. Shembuj të këtyre kategorive përfshijnë:

- Rastet që ndërlidhen me statusin civil (çështja e divorcit, vërtetimi i atësisë) (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 29 marsit 1989, par. 49; dhe *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, par. 44).

- Rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prindër-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët (shih rastet e GJEDNJ-së: *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, par. 72; *Tsikakis kundër Greqisë*, nr. 1521/06, Aktgjykim i 10 majit 2011, par. 64-68; *Paulsen-Medalen dhe Svensson kundër Suedisë*, nr. 16817/90, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, par. 39; dhe *Q. dhe R. kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 20 qershorit 2022, par. 80).

- Rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës, respektivisht ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; çështjet që lidhen me pensionin (shih rastet e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, par. 45; *Obermeier kundër Austrisë*, nr. 11761/85, Aktgjykim i 28 qershorti 1990, par. 72; *Sartory kundër Francës*, nr. 40589/07, Aktgjykim i 1 marsit 2010, par. 34; *Ruotolo kundër Italisë*, nr. 12460/86, Aktgjykim i 27 shkurtit 1992, par. 117; dhe *Borgese kundër Italisë*, nr. 12870/87, Aktgjykim i 26 shkurtit 1992, par. 18).

- Rastet që ndërlidhen me personat të cilat vuajnë nga *"sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë"* (shih rastet e GJEDNJ-së: *X. kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, par. 47; dhe *A dhe të Tjerët kundër Danimarkës,* nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, par. 78-81).

- Rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Caloc kundër Francës*, nr. 33951/96, Aktgjykim i 20 korrikut 2000, par. 120).

- Rastet kur ekziston rreziku për cenimin e të drejtës në edukim (shih rastin e GJEDNJ-së, *Oršuš dhe të Tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, Aktgjykim i 16 marsit 2010, par. 109).

- Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e GJEDNJ-së: *Nicolae Virgiliu Tănas kundër Rumanisë*, cituar më lart, par. 213; dhe *Omdahl kundër Norvegjisë*, cituar më lart, par. 63-64).

(ii) Aplikimi i parimeve të larteckura në rrethanat e rastit konkret

(a) Periudha që do të merret parasysh

72. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës më 19 korrik 1991 kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale për kompensimin e paluajtshmërisë, e cila ishte shpronësuar në pranverën e vitit 1989. Në periudhën kohore mes inicimit të procedurës përmes padisë së lartcekur, e deri në vitin 2003, Gjykata Komunale ka nxjerrë dy Aktgjykime dhe Gjykata e Qarkut dy Aktvendime për rastin, respektivisht përmes vendimit të fundit të vitit 1998 Gjykata e Qarkut e kishte kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën Komunale. Procedura ishte riaktivizuar nga parashtruesi i kërkesës më 20 janar 2003. Rrjedhimisht, Gjykata Komunale më 2 dhjetor 2011 kishte nxjerrë Aktgjykimin [C. nr. 18/03] dhe pas ushtrimit të ankesës nga parashtruesi i kërkesës ky aktgjykim ishte prishur nga Gjykata e Qarkut dhe çështja ishte kthyer serish pranë Gjykatës Komunale. Kjo e fundit, më 16 mars 2016 kishte mbajtur një takim me palët ndërgjyqëse si pjesë e strategjisë shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetruara. Ndërkaq, seanca e parë e shqyrtimit përgatitor për çështjen u mbajt më 23 mars 2017. Referuar përgjigjes së Gjykatës Themelore të prillit 2025, çështja do të procedohet sapo të jenë siguruar ekspertiza nga lëmi i gjeodezisë dhe historiati i paluajtshmërisë i siguruar nga Komuna e Gjakovës.

73. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës daton nga viti 1991, është riaktivizuar në vitin 2003, dhe nuk është vendosur për më tepër se njëzet e dy (22) vjet. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës ka pasur vonesa të pajustifikuara, në vijim do të vlerësojë: (i) kompleksitetin (ndërlikueshmërinë) e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(b) Përkitazi me kompleksitetin (ndërlikueshmërinë) e rastit

74. Gjykata vëren se në procedurat e zhvilluara gjyqësore para gjykatave të rregullta, krahas kërkesës themelore për kompensimin e kundërvlerës për shak të shpronësimit, si çështje kontestuese kanë qenë dhe mbeten: (i) e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesës, respektivisht mungesa e titullit juridik (*iustus titulus*), dhe (ii) mungesa e legjitimitetit të plotë pasiv e të paditurave. Në lidhje me aspektin e të drejtës së pronësisë së parashtruesit të kërkesës, respektivisht legjitimitetit aktiv procedural të tij, si parakusht i parë është bërë administrimi dhe vlerësimi (çmuarja) i disa provave, duke përfshirë dëshmitarët, raportet nga arkivi komunal dhe ekspertizat nga lëmi i gjeodezisë. Gjykata vëren se administrimi i këtyre provave në periudhën e para vitit 2000 është bërë në atë formë që të gjeturat, respektivisht përfundimet, kanë qenë kontradiktore me njëra-tjetrën, kryesisht si rezultat i lëshimeve në përkthimin dhe përshtatjen e deklaratave të dëshmitarëve, dhe precizimit të njësive kadastrale që kanë qenë objekt i aerofotografimit të vitit 1988.

75. Ndërkaq, pas vitit 2003, procesin e administrimit të provave e kanë vështirësuar rrethanat objektive, të cilat kanë ndikuar në sigurimin e të njëjtave si parakusht për procesin e tillë. Gjersa aspekti i legjitimitetit pasiv procedural, që ka qenë kontestues në procedurat e para vitit 2000, po ashtu dhe më pas, ndërlidhet me shuarjen e organeve të cilat fillimisht kanë qenë të paditura. Gjatë zhvillimit të procedurës, rinominimi i palëve të paditura përmes precizimit subjektiv të padisë është bërë dy herë, një herë në vitin 1996 dhe me pas në vitin 2003. Organet e paditura në këtë rast kanë theksuar se mes tyre dhe organeve paraprake nuk ekziston lidhja juridike suksesive, qoftë për shkak të natyrës së organit apo sistemit juridik-kushtetues në të cilat këto organe kanë operuar.

76. Gjykata po ashtu vëren se, në mungesë të vendimit të organit publik kompetent për shpronësimin e realizuar, gjykatat e rregullta, posaçërisht Gjykata Themelore, kanë bërë

administrimin e disa ekspertizave nga lëmia e gjeodezisë, financiare dhe e vlerësimit të palujatshmërive, madje për këto të fundit dhe super-ekspertizë, e cila me kërkesë të parashtruesit të kërkesës tutje është plotësuar në aspektin valoritiv. Krahas me provat e sipërtheksuara, Gjykata Themelore ka realizuar dhe dy seanca për dalje në vend me ekspertët përkatës.

77. Nga sa u tha më sipër, Gjykata vlerëson se çështjet të cilat kanë për objekt pronësinë, posaçërisht përfshijnë rrethana specifike, që në rastin konkret lidhen me vërtetimin e të drejtës së pronësisë, përfshirjen e organeve publike dhe realizimin e shpronësimit (veçanërisht faktik), janë jo të lehta për t'u zgjidhur. Andaj, bazuar në rrethanat e rastit dhe ato objektive, shkresat e lëndës në tërësi, provat e administruara dhe natyrën e tyre, Gjykata vlerëson se rasti përkatës konsiderohet relativisht i komplikuar për t'u vendosur.

(c) Përkitazi me sjelljen e palës

78. Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra procedurale nga parashtruesi i kërkesës, mungesën e ndërhyrjeve jashtëprocedurale, rrjedhimisht ndërhyrjet në rrjedhën e zhvillimit të procedurës, vlerëson se veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës nuk kishin për qëllim shkaktimin e zvarritjeve. Përkundrazi, veprimet e tij tregojnë për interesimin e të njëjtit për përfundimin e procedurës, respektivisht zgjidhjen e kontestit në afatin sa më të shpejtë kohor, duke pasur parasysh faktin e katërmbëdhjetë (14) urgjencave drejtuar Gjykatës Komunale për zgjidhjen e kësaj lënde.

79. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës që nga paraqitja e padisë në vitin 1991, përmes procedurës së zhvilluar deri në vitin 1998, dhe pastaj pas vitit 2003, respektivisht 2007, e gjer tani në fazën aktuale, rrjedhimisht në pritje të epilogut gjyqësor, kishte shprehur interesim për zgjidhjen e kontestit. Andaj vonesat procedurale nuk mund t'i atribuohen të njëjtit. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontribuar në vonesat, shtyrjet, pamundësitë objektive dhe subjektive në mbajtjen e seancave gjyqësore.

(d) Përkitazi me sjelljen e autoriteteve kompetente

80. Gjykata rikujton se në periudhën para riaktivizimit të padisë, respektivisht procedurës së vazhdimit të gjykimit, Gjykata Komunale kishte nxjerrë dy Aktgjykime (1992 dhe 1997). Ndërkaq, Gjykata e Qarkut kishte nxjerrë dy aktvendime (1995 dhe 1998). Ndërsa pas vitit 2003, Gjykata Komunale kishte nxjerrë aktgjykim refuzues në vitin 2011, i cili ishte prishur më 23 prill 2012 nga Gjykata e Qarkut, duke e kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën Komunale. Që nga ajo periudhë çështja nuk është vendosur në shkallë të parë.

81. Gjykata vëren se, pavarësisht faktit që parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e procedurës më 20 janar 2003, seanca e parë është mbajtur pas katër (4) vitesh, saktësisht më 23 prill 2007, e cila është shtyrë më pas deri në nxjerrjen e Aktgjykimit të 2 dhjetorit 2011 nga Gjykata Komunale. Kjo e fundit në këtë periudhe kohore kishte mbajtur katërmbëdhjetë (14) seanca, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë shtyrë për shkak të mospjesëmarrjes së të paditurave dhe njëra prej tyre është mbajtur për dalje në vendngjarje (terren), respektivisht ajo e 24 shtatorit 2007, në të cilën morën pjesë ekspertët nga lëmi i gjeodezisë, bujqësisë dhe financiar, me qëllim të vlerësimit të paluajtshmërive.

82. Gjykata vëren po ashtu se, pas nxjerrjes së Aktvendimit nga Gjykata e Qarkut në prill të vitit 2012, lënda ishte kthyer serish në rigjykim pranë Gjykatës Komunale. Kjo e fundit nuk kishte qenë aktive deri më 23 mars 2017, kur ishte caktuar seanca gjyqësore e radhës. Më 9 tetor 2017, Gjykata Themelore mbajti seancë për dalje në vendngjarje. Gjykata po ashtu vëren se pas vitit 2003 çështja është trajtuar nga katër (4) gjyqtarë të ndryshëm. Gjyqtarja aktuale e ngarkuar me lëndën, bazuar në njoftimin e pranuar nga Gjykata, më 12 mars 2025 dhe 3 prill 2025, rezulton se kjo e fundit u ngarkua me lëndën më 21 qershor 2021. Përmes shkresës së 12 marsit 2025, Gjykata Themelore për Gjykatën ka sqaruar se çështja pavarësisht se është proceduar dhe janë mbajtur seanca gjyqësore, është në pritje të provave të propozuara nga lëmi i gjeodezisë, krahas historiatit të cilin e kishte kërkuar nga Arkivi i Komunës së Gjakovës.

83. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se në çështjen respektive, vetëm në lëmin e gjeodezisë dhe financave janë bërë tri (3) ekspertiza dhe një (1) super-ekspertizë. Çështja është në procedurë rigjykimi që nga viti 2012 pranë Gjykatës Themelore, gjegjësisht për më tepër se trembëdhjetë (13) vjet nga kthimi i saj në rigjykim, dhe për më shumë se njëzet e dy (22) vjet kjo lëndë nuk është zgjidhur ende në instancën e parë.

84. Gjykata po ashtu merr parasysh faktin se kohëzgjatja e vendimmarrjes gjyqësore, përveç tjerash i atribuohet edhe pasivitetit të organeve publike, të cilat në rolin e palëve në procedurë, përfshi të padituratt, respektivisht organet publike, ndikuan drejtpërsëdrejti në vonesat e vendimmarrjes. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se ndikim në kohëzgjatjen e procedurave kanë pasur dhe vonesat e paarsyeshme të ekspertëve në hartimin, rrjedhimisht dorëzimin e raporteve në Gjykatën Themelore, që përfshin periudhat prej një (1) deri në gjashtë (6) muaj, edhe pse afati gjyqësor ka qenë pesëmbëdhjetë (15), respektivisht tridhjetë (30) ditorë, ndërkaq Gjykata Themelore nuk ka vepruar në linjë me përcaktimet e Ligjit për Procedurën Kontestimore, që parasheh sanksione ndaj ekspertëve që shkelin këto afate. Saktësisht, nga viti 2003 e deri në vitin 2025 janë mbajtur tridhjetë (30) seanca gjyqësore.

85. Duke pasur parasysh të lartcekurat, posaçërisht rrjedhën procedurale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në veprimet e ndërmarra nga palët, procedurat e provës dhe ato të ndërmjetme që lidhen me sigurimin e tyre, pasivitetin e palëve të paditura, rrethanat objektive që lidhen me çështjen, posaçërisht natyrën e saj, Gjykata konstaton se këto elemente, vështruar kumulativisht, në një masë mund të përbëjnë arsyetim për gjykatën e shkallës së parë, për në vonesa në procedim. Megjithatë, periudha e këtyre vonesave nuk mund t'i atribuohet në rrethanat e rastit konkret palës paditëse, e cila nuk ka vetë kontribut në zvarritjen e çështjes. Andaj, periudha kohore prej më shumë se njëzet e dy (22) vjet në pritje të zgjidhjes së lëndës civile në fjalë i atribuohet Gjykatës Themelore si gjykatë kompetente.

(e) Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest

86. Gjykata përsërit se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar (*particular diligence*) dhe vendimmarrje më të shpejtë, kështu duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: çështjet që lidhen me statusin civil, rastet e kujdestarisë së fëmijëve, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet që ndërlidhen me personat që vuajnë nga *"sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë"*.

87. Gjykata vëren se rasti në fjalë nuk bën pjesë në kategorinë e rasteve të cilat për nga natyra juridike kërkojnë zgjidhje të shpejtë. Megjithatë, pavarësisht kësaj, Gjykata vlerëson se kjo nuk nënkupton që rastet që nuk gëzojnë prioritet, duhet zgjidhur me neglizhencë dhe në afate të tejzgjatura, të cilat nuk mund të konsiderohen të arsyeshme.

88. Gjykata, pa paragjykuar epilogun përfundimtar të çështjes, ka parasysh faktin se kontesti ka për objekt kompensimin e paluajtshmërisë si e drejtë e cila realizohet në formë të kundërvlerës për pronën e shpronësuar, andaj duke riafirmuar parimin e përgjithshëm të absolutitetit të së drejtës së pronësisë, në këtë kontekst, përshtatshmërisht rikujton rastet e GJEDNJ-së: *Guiso-Gallisay kundër Italisë*, nr. 58858/00, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009; *Pálka dhe Të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 30262/13, Aktgjykim i 24 qershorit 2022; *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, nr. 7151/75, 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982; *Matos e Silva, LDA dhe të tjerë kundër Portugalisë*, nr. 15777/89, Aktgjykim i 16 shtatorit 1996; dhe *Ellia S.R.L. kundër Italisë*, nr. 37710/97, Aktgjykim i 2 nëntorit 2001.

Përfundim

89. Nga sa më sipër, Gjykata nëpërmjet aplikimit kumulativ të kritereve të sipërtheksuara, konstaton: (i) se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest civilo-juridik që ka për objekt kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar, pa vendim të organit publik, me aspektin e vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me përcaktimin e suksesorëve juridikë në kuadër të sistemit paraprak, dhe si e tillë çështja rezulton të jetë relativisht e ndërlikuar për t'i dhënë epilog; (ii) se parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, dhe (iii) se Gjykata Themelore për më tepër se njëzet e dy (22) vite, nuk e ka zgjidhur çështjen ende dhe rrjedhimisht kjo vonesë është e pajustifikueshme.

90. Thënë këtë, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

II. Efektet juridike dhe kërkesa për kompensim

91. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro "*në emër të dhimbjeve shpirtërore*". Në këtë kontekst, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet e Gjykatës: *KI10/18*, parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, par. 119; *KI108/18*, parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shtatorit 2019, par. 197; *KI19/21*, parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022, par. 115; *KI06/21*, cituar më lart; *KI64/23*, cituar më lart, par. 104).

92. Lidhur me këtë, Gjykata ripërsërit se në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të *"shpërblimit të drejtë"*, sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i

domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës, *KI113/21*, parashtrues *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, par. 145-151; *KI10/18*, cituar më lart; *KI108/18*, cituar më lart; *KI06/21*, cituar më lart).

93. Gjykata për fund vlerëson se, pas këtij Aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta, e posaçërisht Gjykata Themelore duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike me dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 2 korrik 2025, njëzëri:

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TA URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë, që jo më larg se 3 janar 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha Nexhmi Rexhepi